

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TROPOJË

Nr. 1810/2 Prot  
Dt. 30/3/2023

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Date 30.03.2023

**RAPORT**

**PËR PUNËN KËSHILLIT TË BASHKISË PËR 12 - MUJORIN E  
VITIT 2022**



Të nderuar këshilltarë !

Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisë bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë, duke përdorur me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet burimet njerëzore, financiare, fizike e natyrore si dhe teknologjike të Bashkisë.

Veprimtaria e Këshillit Bashkiak mbështetet në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligjet, aktet nënligjore në zbatim të tyre si dhe rregulloret e miratuara nga vet këshilli si më poshtë:

**Vendimmarrja**

Gjatë vitit 2022 janë zhvilluar mbledhje komisionesh me pjesëmarrjen e këshilltarëve. Numri më i madh i mbledhjeve të komisioneve është ai i komisioneve të përhershme me 21 mbledhje.

Për periudhën janar – dhjetor 2022, janë marrë 127 vendime gjithsej në Këshillin Bashkiak Tropoje, nga të cilat 60 është shprehur pozitivisht për ligjshmërinë Institucioni i Prefektit të Qarkut Kukës.

Numrin më të madh të vendimeve e përbëjnë vendimet që kanë të bëjnë me 6%, ndihmat sociale, ndihmat emergjente, qytetar nderi, pastaj vijnë vendimet, në lidhje me buxhetin . Mund të përmendim si vendime kryesore gjatë vitit të kaluar si:

1. Vendimi I Buxhetit per vitin 2023, ku u miratua buxheti dhe prioritet per vitin 2023.
2. Hapja e disa rrugeve ne fshatra.

Gjatë mbledhjeve të këshillit kanë pjesë 21 këshilltarë. Mbledhjet frekuentohen nga 80% e këshilltarëve. Ka një numër të madh këshilltarësh që nuk marrin pjesë rregullisht në mbledhjen e

këshillit dhe komisioneve, duke krijuar një problem në mbajtjen e mbledhjeve. Edhe vonesat në fillimin e mbledhjeve mbeten një problem që duhet zgjidhur në vazhdimësi.

I gjithë dokumentacioni projekt vendimeve të shqyrtuara gjatë mbledhjeve të Këshillit është publikuar në faqen web të këshillit për tu dhënë mundësi qytetarëve të njihen me to. Në regjistrin online për transparencën e mbledhjeve të këshillit janë dokumentuara të gjitha informacionet mbi mbledhjet duke filluar nga thirrja e mbledhjes, oraret e mbajtjes, videot e mbledhjes dhe proces verbalët tyre. Mbledhjet e Këshillit janë transmetuar shumica dërmuese online në facebook të Këshillit Bashkiak dhe në mediat lokale. Duke filluar nga ky vit Këshilli Bashkiak do të vazhdojë të transmetojë mbledhjet livestream në facebook të mundësuar nga bashkëpunimi me projektin Bashki të Forta (financuar nga Qeveria Zvicerane). Kjo i jep Këshillit Bashkiak një pavarësi në transmetimin pandërprerje livestream të mbledhjeve dhe i krijon mundësi të jetë transparent në lidhje me të gjitha vendimet që merret dhe problemet që trajton për të ardhur në ndihmë qytetarëve.

### **Kërkesat dhe ankesat e qytetarëve**

Në total në Këshillin Bashkisë Tropoje për periudhën Janar-Dhjetor 2022 janë regjistruar 124 kërkesa nga të cilat rreth 50% e tyre është trajtuar në Këshill Bashkiak ndërsa pjesa tjetër është trajtuar shkresërisht. Pjesa më e madhe kërkesave ka qënë për emërtime rrugësh dhe kërkesa për informacion, dhe kërkesa për ndihmë në raste veshitësie ekonomike dhe semundjesh. Ka shumë pak ankesa nga qytetarët, me të cilët duhet shtuar komunikimi për të ftuar ata të adresojnë shqetësimet e tyre tek Këshilli Bashkiak.

Gjatë kësaj periudhe është regjistruar 1 peticion dhe problemeve të shtruar nga ky peticion Këshilli ka ftuar Bashkinë të japë përgjigje shqetësimit të qytetarëve. Bashkia u është përgjigjur qytetarëve me një shkresë sqaruese për problemin e shtruar duke e vendosur si prioritet në listën projekteve të rëndësishme të Bashkisë. Të gjitha kërkesat dhe ankesat janë të publikuara në regjistrin online të kërkesë-ankesave në faqen web të Këshillit Bashkiak.

### **Aktivitetet kryesore të Këshillit**

Gjate vitit 2022 Këshilli bashkiak plotesoi kuadrin rregullues të  
Vizita studimore,  
Pjesëmarrja në degjese publike,  
Takim me rinjte mbi aktivitetet.

